# DËSHMI ARKIVI

**A-477344**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Mbledhja e Këshillit të Sigurisë, protestuesi: Tentativë për të hequr përgjegjësinë e Ramës nga skandali i SHISH \| |
| ADRESA | `https://boldnews.al/2026/09/28/mbledhja-e-keshillit-te-sigurise-protestuesi-tentative-per-te-hequr-pergjegjesine-e-rames-nga-skandali-i-shish/` |
| BURIMI | boldnews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 18:24:50 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 18:22:23 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `333b9ea4ac1a0b93e7813090b3adec7cdc9dfdd673483b3f7dfa38fc0aee4e0c` |
| TEKSTI | `b2e718c97ec53b8bf33d8216eb53a97ca37fe453ee42c4893ed1259c19cafa56` |
| PAMJA | `72dbb0d5c9bb9b8b435e67d88eeaf92d22eaba3d9e936a40fbe8785faa883550` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4267495f33c80e132e3abbc63f70ed4a28c842fc91e489077e90f5e767cdf6f3` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `e5625a2b3a70b3c40eaff938d2f4a87fb4cf81b6cc2ef2b38db74408074a14f5` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4267495f33c80e132e3abbc63f70ed4a28c842fc91e489077e90f5e767cdf6f3`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Mbledhja e Këshillit të Sigurisë, protestuesi: Tentativë për të hequr përgjegjësinë e Ramës nga skandali i SHISH

20:22 : 28/09/2026 në AKTUALITET, Lajmet e Dites



Një prej protestuesve që mori fjalën gjatë tubimit të 121-të në Tiranë e lidhi protestën e qytetarëve me zhvillimet e fundit rreth SHISH-it dhe mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare.

Sipas tij, mbledhja e thirrur nga Presidenti Bajram Begaj nuk ishte një përpjekje për të adresuar përgjegjësitë për situatën e krijuar, por një mënyrë për t'ia larguar vëmendjen publike kryeministrit Edi Rama.

Protestuesi deklaroi se qytetarët që janë mbledhur në shesh nuk janë aty për bindje partiake, por për atë që ai e konsideron interesin e tyre.

Ai akuzoi qeverinë se gjatë 13 viteve në pushtet ka prodhuar një seri skandalesh dhe e ka shndërruar korrupsionin në një problem të sistemit.

Në fjalën e tij, ai përdori në mënyrë ironike edhe referencën e Ramës për Romën, duke deklaruar se kryeministri nuk ndërtoi "Romën" që kishte premtuar, por sipas tij, një sistem të dominuar nga korrupsioni dhe interesat e grupeve të fuqishme.

Lexo edhe:

Nga dorëheqja e Ramës te qeveria teknike, aktivistja rikujton kërkesat e protestuesve

Dita e 121-të, qytetarët marshojnë drejt Kryeministrisë: Arrestoni Ramën dhe Ballukun

"Roma që Edi Rama ndërtoi ishte Roma e një narkoshteti, ishte Roma e skandaleve korruptive", deklaroi protestuesi.

Në vijim, ai ngriti akuza edhe për lidhje mes qeverisë, krimit të organizuar, oligarkëve dhe

TË GJITHA


Nga dorëheqja e Ramës te qeveria teknike, aktivistja rikujton kërkesat e protestuesve
20:22 : 28/09/2026


Mbledhja e Këshillit të Sigurisë, protestuesi: Tentativë për të hequr përgjegjësinë e Ramës nga skandali i SHISH
20:22 : 28/09/2026


Ukraina raporton bombardime vdekjeprurëse ruse në Kiev
20:11 : 28/09/2026


Vihet nën kontroll zjarri në Fieri, tre persona shoqërohen në polici
20:09 : 28/09/2026


Biznesi i verës, firma e ndërtimit dhe tenderat/ Si u shumëfishua pasuria e çiftit Ergys-Dorina Verdho
19:55 : 28/09/2026


WSJ: Si e ndihmoi ambasadorja amerikane "Aktor Group" të siguronte marrëveshjen 6 mld dollarëshe në Shqipëri
19:48 : 28/09/2026


Dita e 121-të, qytetarët marshojnë drejt Kryeministrisë: Arrestoni Ramën dhe Ballukun
19:36 : 28/09/2026

pastrimit të parave, ndërsa pretendoi se drejtësia është përdorur politikisht.

Protestuesi e mbylli fjalën e tij me një kërkesë të drejtpërdrejtë ndaj kryeministrit, duke kërkuar dorëheqjen e tij dhe duke thënë se përgjegjësia politike, sipas tij, i takon edhe kreut të qeverisë për veprimet e vartësve.

“Kryeministër, ne për ty duam burg, ama minimalisht jep dhe dorëheqjen”, u shpreh ai.

**Etiketa:** Edi Rama | keshilli i sigurise | protestuesi

## Lajme të lidhura



**Nga dorëheqja e Ramës te qeveria teknike, aktivistja rikujton kërkesat e protestuesve**
20:22 : 28/09/2026



**Dita e 121-të, qytetarët marshojnë drejt Kryeministrisë: Arrestoni Ramën dhe Ballukun**
19:36 : 28/09/2026




**“Shumë karrige, shumë fjalë, po përgjegjësia?”/ Protesta e 121-të, pankartat për Ramën dhe Hysenin**
19:03 : 28/09/2026




**Kur skandali kthehet në sukses/ Anatomia e një fjalimi të Edi Ramës**
18:28 : 28/09/2026



**Këshilli i Sigurisë përforcon alibinë e Ramës për Vlora Hysenin**
17:53 : 28/09/2026



**Mbledhje te “Vila e Kuqe”, Rama thërret sot drejtuesit politikë të PS**
12:42 : 28/09/2026

BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.
Na kontakto: [email protected]

NA NDIQ

2026 Boldnews Dev By Techzero1.com

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.